Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0728

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani Kryetare, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Traffiks VA" Sh.P.K. të datës 25.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovëstë datës 04.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me shenja të trafikut mobil për paralajmërim dhe për ndalje të automjeteve motorike" me numër të prokurimit 214-23-8152-1-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 16.11.2023 merr këtë:

Vendim

1.Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Traffiks VA" Sh.P.K. me nr. 2023/0728 të datës 25.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovëstë datës 04.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me shenja të trafikut mobil për paralajmërim dhe për ndalje të automjeteve motorike" me numër të prokurimit 214-23-8152-1-2-1.

2.Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovëstë datës 04.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.08.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shenja të trafikut mobil për paralajmërim dhe për ndalje të automjeteve motorike" me nr. të prokurimit 214-23-8152-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 22,000.00€.

Me datë 13.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 së bashku me Letrën Standarde për eleminimin e operatorit ekonomik ankues si të papërgjegjshëm.

Me datë 11.09.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 13.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 25.09.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar ankesën me shenjën 2023/0728.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "*Ju sqarojmë se katalogu i prodhuesit është gjeneral dhe nuk përfshinë detajet e pajisjeve. Disa prodhues nuk i vendosin të gjitha të dhënat dhe karakteristikat e shenjave apo produkteve, mirëpo ky fakt mund të sqarohet lehtë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP. Kjo mund të vërehet edhe*

te katalogu në faqen nr. 5 pika 3 ku shkruan se teksti në shenja bëhet në bazë të porosive të klientëve. Po ashtu edhe sa i përket peshës së kërkuar maksimale prej 7 kg, ju sqarojmë se edhe për këtë karakteristikë apo specifikë prodhuesi nuk i vendos dhe nuk i përshkruan në katalog për shkak se shenjat e trafikut kanë dimensione të ndryshme, forma të ndryshme dhe varësisht nga dimensioni i shenjave ndryshon edhe pesha, prandaj në bazë të kërkesave të klientëve punohet madhësia, forma dhe mbi bazën e kërkesave të klientëve vie edhe deri te pesha e shenjave. Edhe kjo pikër ka mundur të sqarohet përmes kërkesës për sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP, qoftë duke kërkuar sqarime nga ne si operator ekonomik apo nga prodhuesi drejtpërdrejtë. Në lidhje me këto arsye të eiminimit, ne kemi kërkuar sqarime nga prodhuesi ku i njëjti ka deklaruar se fotot në katalog shërbejnë vetëm për ilustrim, ndërsa produktet që do të prodhohen së pari duhet të miratohen nga ana e klientit dhe prodhimet mund të kryhen sipas specifikimeve të kërkuara nga klienti".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 62, 69 dhe 72 të LPP si dhe nenin 43 të RRPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues ne vendimin e datës 04.09.2023 ka pohuar se ky aktivitet i prokurimit anulohet ne mungesë të ofertave të përgjegjshm, kurse sa i përket ankuesit AK ka pohuar se ne DT është kërkuar nga ofertuesit që duhet të ofrojnë katollog/broshurë me të cilën ëeshtë e mundur vlerësimi i specifikacionit teknik të ofruar, siç kërkohet në specifikime teknike (ankesi1) ndërsa OE ankues katalogun/broshurën të cilën e ka ofruar janë shenjat e trafikut mirëpo produktin të cilin ne e kemi kërkuar nuk është në katalog fare, andaj ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm për këtë aktivitet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 26.09.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 29.09.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Operatori Ekonomik ka dorëzuar me ofertë katalogun gjeneral të prodhuesit në të cilin nuk janë të përfshira detajet e kërkuara me dosjen e tenderit dhe specifikimin teknik. Në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën në OSHP, operatori ekonomik ankues ka dërguar një dokument nga prodhuesi në të cilin prodhuesi sqaron se vetëm pas dërgesës së urdhërblerjes mund të ekzekutojnë porosinë sipas kërkesës se blerësit. Eksperti shqyrtues vlerëson se përkundër faktit se AK ka kërkuar nga OE që të dorëzojnë Katalogë/broshurë nga prodhuesi me përshkrime të specifikacioneve teknike siç kërkohet në specifikacionin teknik i njëjti nuk i ka ofruar. Gjatë kërkesës për rishqyrtim OE ankues sipas shkresës së prodhuesit i cili ka deklaruar se duhet të dërgohet një urdhërblerje me shkrim nga kontraktori në mënyrë që të ekzekutojnë porosinë sipas kërkesave, pra nuk ka ofruar mallrat sipas kërkesave. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjate vlerësimit te ofertave ka vepruar ne përputhje me nenin 59 paragrafi 4 të LPP ku përcaktohet se "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Po ashtu AK-ja ka vepruar në përputhje me RRUOPP neni 39.8 kur nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues. Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet ankimore i referohen kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional sipas dosjes së tenderit ku është kërkuar si në vijim:

a. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog/broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i s pecifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).
b. Katalogë/broshurë nga prodhuesi me përshkrime të specifikacioneve teknike siç kërkohet në specifikacionin teknik (Aneksi 1).

Në bazë të specifikimit teknik është kërkuar që të gjitha anët e shenjës duhet të përmbajnë tri shenja të ndryshme me mbishkrime të dallueshme (sipas mostrave) të cilat janë: stop Police, rrezik në rrugë, dhe aksident në rrugë Shenjat duhet të jenë të punuara sipas cilësisë së bashkimit evropian. Shenja e trafikut duhet të jetë 90 cm, ndërsa së bashku me kornizën nuk duhet të kalojnë më shumë se 110cm ndërsa pesha maksimale ë jetë shtatë (7) kg.

Përmes administrimit të dosjes së dokumenteve me të cilën ka ofertuar ankuesi, Paneli Shqyrtues ka gjetur se është dorëzuar një katalog gjeneral mirëpo nuk është dorëzuar katalogu/broshura me përshkrime të specifikave teknike sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Prandaj Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit të ekspertit shqyrtues ku thuhet se "Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar me ofertë katalogun gjeneral të prodhuesit në të cilin nuk janë të përfshira detajet e kërkuara me dosjen e tenderit dhe specifikimin teknik". Po ashtu Paneli Shqyrtues konsideron se ky fakt nuk është kontestues as për vet ankuesin pasi që në pretendimet ankimore ndër të tjera thuhet se "Ju sqarojmë se katalogu i prodhuesit është gjeneral dhe nuk përfshinë detajet e pajisjeve. Kjo mund të vërehet edhe te katalogu në faqen nr. 5 pika 3 ku shkruan se teksti në shenja bëhet në bazë të porosive të klientëve". Në këtë mënyrë ka gjetur se operatori ekonomik ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit që nënkupton se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij si të papërgjegjshëm është i bazuar në nenin 59 paragrafin 4 të LPP ku përcaktohet se "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Për këto arsye pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli Shqyrtues ka shqyrtuar edhe pjesën tjetër të pretendimeve ankimore ku thuhet se Autoriteti Kontraktues do të duhej që të kërkonte sqarime shtesë lidhur me katalogun e ofertuar nga operatori ekonomik ankues. Me këtë rast duhet theksuar se përmes pikës 10 të UPP është përcaktuar se në rastet kur "është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara" atëherë Autoriteti Kontraktues duhet të "refuzon tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit të ekspertit shqyrtues ku thuhet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë të drejtë kur nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik ankues.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. **Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.**

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovëstë datës 04.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me shenja të trafikut mobil për paralajmërim dhe për ndalje të automjeteve motorike" me numër të prokurimit 214-23-8152-1-2-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **TRAFFIKS VA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: